

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

Fakulteti i Filologjisë

Dega: Gjuhë Shqipe



PUNIM DIPLOME

**TEMA: LEKSIKU DHE MËNYRAT E FORMIMIT TË FJALËVE TË RAJONIT TË
LIPOVECIT**

MENTORI:

Prof. as. dr. Muharrem Gashi

KANDIDATI:

Durim Lushaj

Gjakovë, 2018

**Tema: LEKSIKU DHE MËNYRAT E FORMIMIT TË FJALËVE TË RAJONIT TË
LIPOVECIT**

Komisioni vlerësues :

1. _____ (mentor),
2. _____ (kryetar i komisionit),
3. _____ (anëtar i komisionit),

Nota: _____

Abstrakti

Në këtë punim tema është për fjalët dhe mënyrat e formimit të tyre në zonën e Lipovecit. Të folurit dhe leksiku i një krahine të veçantë, paraqet një tërësi trajtash dhe varietetesh të të folurit. Shumë elemente të formimit gjuhësor në këtë rajon janë pëfëtuar, në rrjedhën e natyrshme të praktikës së formimit gjuhësor, por që kanë dallim me gjuhën e njësuar dhe kanë nevojë për një rregullim të përgjithshëm në sistem gjuhësor. Përveç kësaj, kemi elemente të të folurit, që janë huazuar nga vende dhe krahina të ndryshme, të cilat janë bërë pjesë e kesaj zone edhe pse për të njëjtat elemente kanë pasur fjalë vendase në përdorim.

Megjithatë, shumë prej fjalëve në këtë rajon, janë ngritur në rrafshin e normës. P.sh. fjala “dritare” ka menjanuar fjalët dialektore të huazuara “penxhere”, “prezore” pothuajse nga të gjitha përdorimet e moshave të ndryshme. Me zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë, të ekonomisë, të kulturës etj., është zhvilluar edhe leksiku, kanë lindur e kanë hyrë në përdorim shumë fjalë të reja, shumë fjalë të njohura kanë ndryshuar formën ose kuptimin, ndërsa shumë fjalë të tjera janë vjetruar e kanë dalë nga përdorimi i gjallë.

Fjalët kyçe: e folmja, fjalëformim, huazime, leksiku.

FALENDERIMI

Kam kënaqësinë që në përfundim të këtij punimi t'i falenderoj të gjithë ata që me mbështetjen e tyre bënë të mundur që unë të realizoj këtë punim.

- Falenderoj në mënyrë të veçantë familjen time, që më ka përkrahë në mënyrë ta pa kursyer deri në përfundim të studimeve të mija.
- Shpreh mirënjohje, për profesorin mentor Dr.sc. Muharrem Gashi për kohën, sygjërimet dhe ndihmesën që dha në këtë punim.
- Falenderimi i takon edhe antarëve të komisionit për mbështetjen dhe vlerësimin e duhur të këtij punimi.

PËRMBAJTJA

Abstrakti.....	3
Falenderimi.....	4
1.1. Hyrje.....	6
1.2. Leksikologjia si shkencë gjuhësore.....	7
1.2.1. Parimet teorike kryesore të leksikologjisë	8
1.2.2. Leksiku i gjuhës shqipe dhe zhvillimi historik i tij.....	9
1.3. Fjala si njësi leksikore.....	11
1.4. Forma dhe kuptimi i fjalës.....	12
1.5. Grupet (paradigmat e fjalës).....	13
1.6. Leksiku i të folmes në rajon të Lipovecit.....	14
1.7. Fjalëformimi.....	16
1.7.1. Prejardhja parashtesore.....	16
1.7.2. Prejardhja prapashtesore.....	17
1.8. Huazimet.....	18
1.8.1. Fjalë të burimit sllav.....	19
1.8.2. Fjalë të burimit turk.....	20
1.9. Përfundimi.....	23
1.10. Bibliografia.....	24

HYRJE

Në këtë punim diplome janë trajtuar proceset e leksikut dhe të formimit të fjalëve në të folmen e Lipovecit një pjesë nga Hasi. Ky rajon shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe si e tillë bën pjesë në gegërishten verilindore. Ka disa veçori gjuhësore, që e dallojnë nga të folmet e tjera shqipe, por gjithsesi karakterizohet me tiparet e gegërishtes verilindore. Gjatë punës kërkimore nga ana jonë është grumbulluar një numër i konsiderueshëm fjalësh. Shumica e këtyre proceseve i kanë përfshirë ato fjalë dialektore, që s'përkojnë me format gjegjëse të gjuhës standarde. E folmja e brezit të ri pak a shumë është bashkëkohore, por nuk është në nivel të gjuhës standarde. Ajo kryesisht kultivon edhe ruajtje të së folmes së vjetër (të dialektit gegë) që është në kundërvënie me normën leksikore të gjuhës sonë standarde, sepse kjo e folme qëndron jashtë kufijve të gjuhës së njehesuar e të përgjithshme.

Qëllimi i këtij punimi është që të dallojmë leksikun e fjalëve në këtë të folme, duke parë se cilat nga ato i gjejmë më shpesh, dhe cilat kategori të fjalëve i përfshijnë. Dallimet e leksikut të një të folme janë dallime që e pasurojnë gjuhen shqipe e cila është *gjuhë e një bashkësi kombëtare*.¹ Dhe si e tillë kjo gjuhë na paraqitet e organizuar në mënyrë hiarkike. Shtresën e parë të gjuhës së përbashkët e përbëjnë ligjerimet e individëve të veçantë; mbi këto ngrihen *të folmet vendore*, si p.sh. të folmet e fshatrave, qytetzave a qyteteve të veçantë. Një shkallë më lartë vijnë të *folmet krahinore*. Një grup të folmesh krahinore me ngjashmëri të dukshme midis tyre përfshihen në një *nëndialekt*, që është një sistem gjuhësor i një shkallë më të lartë. Nëndialektet e përafërta, nga ana tyre, përfshihen në *dialektet* që janë ndarjet më të mëdha të një gjuhe.

Në këtë punim do të shpjegohen edhe karakteristikat e fjalës.

Kjo fushë studimore zgjerohet prej leksikut duke prekur sidomos aspektet larmitë e variacioneve që shfaqen me vlera të burimeve leksikore të ndryshme.

¹ Mamushaj Rami "Shqipja standard" 2004, fq. 45

1.1. Leksikologjia si shkencë gjuhësore

Leksikologjia është shkencë gjuhësore, që studion fjalët si njësi leksikore dhe leksikun, d.m.th. tërësinë e fjalëve, nga ndërtimi, nga kuptimi, nga shtresimi i mundshëm etj².

Fjala leksikologji vjen nga greqishtja e vjetër: „lexis“ = fjalë dhe „logos“ =s fjalë ; d.m.th fjalë për fjalën, ose shkenca mbi fjalën. Leksikologjia është ajo degë (shkencë) e gjuhësisë, që merret me studimin e përbërjes leksikore të gjuhës dhe në mënyrë të veçantë, me studimin e hallkës më të vogël në përbërjen leksikore, të fjalës.

Tërësia e fjalëve të gjuhës shqipe përbën leksikun e gjuhës shqipe, pra të gjitha fjalët që përdorin shqipfolësit.

Shkenca mbi fjalën, leksikologjia mund të jetë: e përgjithshme, e veçantë, historike dhe përshkruese.

Leksikologjia historike: i studion fjalët në aspektin historik, d.m.th studion ndryshimin e fjalëve nga ana e formës dhe e kuptimit në etapa të ndryshme historike dhe lëvizjet e fjalëve që nga fillimi gjer tani.

Leksikologjia përshkruese: studion fjalën dhe leksikun në gjendjen e tyre të sotme me veçoritë dhe karakteristikat e tyre në situatën apo gjendjen aktuale.

Leksikologjia e përgjithshme: studion parimet e përgjithshme teorike të fjalës dhe të leksikut.

Leksikologjia e veçantë: studion anët e veçanta, specifike, karakteristike të një gjuhe.

Pjesët e leksikologjisë janë:

- a) Semasiologjia
- b) Leksikografia
- c) Frazeologjia

² Thomani Jani, “Leksikologjia e gjuhes shqipe”, 2006

1.1.2. Parimet teorike kryesore të leksikologjisë

Në dhjetë vjetët vijues, 1960-1970, u përpunuan më tej e u ngulitën idetë e parimet teorike kryesore, të cilat qëndrojnë në themel të leksikologjisë së gjuhës shqipe si shkencë dhe përcaktojnë zhvillimin e saj të mëtejshëm. Këto ide e parime lidhen me të gjitha anët e leksikut të shqipes. Po shënojmë disa prej tyre:

1. Leksiku dhe frazeologjia shqipe vlerësohen si pasuri kulturore e përbashkët, që duhet mbledhur e duhet studiuar me synimin që të shërbej për zhvillimin e gjithëanshëm të gjuhës shqipe standard, për ta bërë këtë gjuhë sa më të fuqishme e më shprehëse.
2. Brenda kësaj pasurie bëhet shtresimi sipas vlerave reale, sipas dobisë që i sjellin mjetet e leksikut e të frazeologjisë të gjuhës sonë të sotme, pavarësisht nga krijuesit ose nga krahina.
3. Në tërësinë e mjeteve leksikore e frazeologjike vendi kryesor i jepet pasurisë së krijuar nga populli. Fjalët frazeologjike popullore përbëjnë bërthamën e leksikut të gjuhës sonë të sotme, gurra popullore shihet përherë si burim i pashtershëm edhe për fjalët e shprehje që i nevojiten gjuhës letrare.
4. Leksiku i gjuhës sonë vështrohet si një sistem i plotë e i organizuar njësi gjuhësore. U kapërcye me këtë mënyrë gjendja e mëparshme e studimeve, që trajnonin njësi të veçuara e të shkëputura të leksikut. Nisi kështu studimi i lidhjeve të brendshme e të ndërsjella të fjalëve e të klasave të fjalëve, nga përmbajtja dhe nga ndërtimi i brendshëm.
5. Fjala, frazeologjia, kuptimi, shtresat e leksikut etj. Studiohen nga shumë anë, vlerësohen lidhjet ndërmjet njësive e kategorive, vlerate gjalla e prirjet e zhvillimit, forma e përmbajtja, shkalla e përpunimit të normës letrare etj. Fjala dhe leksiku filluan të shihen jo si njësi të vdekura, por si njësi që zhvillohen e ndryshojnë paprerë, që përsosen vazhdimisht, krahas zgjerimit e përsosjes së funksioneve shoqërore të gjuhës sonë standard.

6. Mbledhja e studimi i fjalëve e i frazeologjisë shqipe shtrihen në gjerësi, bëhen çështje të mësuesve, shkrimtarëve, të punonjësve të kulturës, të specialistëve të prodhimit etj. U mblodhën dhe u studiuan jo vetëm fjalë të rralla e shprehje të bukur, por edhe fjalë të njohura, frazeologji, kuptime të veçanta, lidhje fjalësh etj., për të dëshuar kështu format, përdorimet, shtrirjen gjeografike dhe lidhjet e njësive leksikore ndërmjet tyre.

1.2. Leksiku i gjuhës shqipe dhe zhvillimi i tij historik

Fusha leksikore

Gjuha shqipe, ashtu si çdo gjuhë, ka një numër të madh fjalësh. Disa prej këtyre fjalëve kanë më shumë se një kuptim. Tërësia e fjalëve të një gjuhe quhet leksik. Pra, leksiku është një lum i gjatë fjalësh, por ai nuk është thjeshtë një listë fjalësh që ekziston në mendjen tonë. Ai është një sistem ku çdo fjalë ka vendin e vet dhe është gjithmonë në lidhje me fjalë të tjera. Çdo grup fjalësh që lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet kuptimit të veçantë që ato shprehin, përbëjnë një fushë leksikore.

Në shekujt XVI-XVII, siç.. del në veprat e autorëve të vjetër(të Gjon Buzukut, të Pjetër Budit, të Frang Bardhit, të Pjetër Bogdanit, të Lekë Matrangës, të Gjon Kazazit etj), gjuha shqipe paraqitet në përgjithësi e përpunuar dhe e pasur në leksik³. Këta autorë u kujdesën për të ruajtur të pasur fjalorin e gjuhës sonë, për të nxerrë në dritë “fjalë plaka e të harrueme”, siç thotë Pjetër Bogdani, që gjuha jonë po “bastardohet”. Që në “Fjalorin latinisht-shqip” të reja: kërkues, këshilltar, kopështar, letërar, luftëtar, ndërrues, shitës, shpenzues.

Një shtresë tjetër e leksikut në veprat e autorëve të shekujve XVI-XVII e përbëjnë fjalët e reja të krijuara prej tyre. Ata e pasuruan leksikun e shqipes me shumë fjalë të krijuara me burmin e vetë gjuhës, duke përdorur disa mënyra për formimin e fjalëve të reja. Kështu, kanë formuar *emra abstraktë nga mbiemrat cilësorë*: të mirët, të padijtunit, të shkruemit.; *emra abstraktë me*

³ Thomai, Jani, “Leksikologjia e gjuhes shqipe”, 2006

*prapashtesën –i ose –ni: dhuni, kërthinjëni, parabijëni...; emra abstraktë të cilësisë me prapashtresen –ri: bashkari, përngjashmëri, ...; emra të përbërë : dijekeqi. Siç shihet, autorët tanë të vjetër kanë krijuar fjalë me brumin e gjuhës sonë dhe sipas ligjeve të veprat e tyre dhe nuk pati jetë të gjatë. Ndër ato që s’hyjnë në përdorim, ka fjalë që janë të bukura e të formuara drejt, që mund të rigjallërohen, të paktën me funksione e stile të veçant: *dredhje “ciklon”, hijëzi “ombrellë”, ëmbëlsoj “ngushëllojë, ndoroj “administroj”, humboj”bie në fund”* etj.*

Në leksikun e atorëve të vjetër ka edhe fjalë që sot nuk i përdorim, fjalë të vjetra që kanë kuptim tjetër ose përdorim të kufizuar krahinor: me u grishunë” thirrem” (të të gjithë autorët e vjetër), me gjegjunë “degjojë” (sotë në Dibër e tek arbëreshët e Italise), me përzanë “pranoj”(te vepra e Gjon Buzukut) etj.

3.1. Fjala si njësi leksikore

Në gjuhësi janë bërë shumë përpjeke për të kufizuar fjalën dhe për të përcaktuar kufijtë e saj, megjithatë mbeten ende mjaft çështje të diskutueshme. Vështirësi të veçanta paraqet cilësimi i njësive leksikore të ndërmjetme, midis morfemës, nga njëra anë, dhe fjalës ose togëfjalëshit, nga ana tjetër.

Dihet që njësitë themelore të gjuhës janë fonema, morfema, fjala, togëfjalëshi dhe fjalia. Siç shihet, në këtë varg, që shkon nga njësia më e ulët te më e larta, nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, fjala zë vend në mes të morfemës dhe të togëfjalëshit. Po të vendosim kufi të drejtë e të qartë ndërmjet këtyre njësive, përcaktojmë në të njëjten kohë edhe kufijtë e fjalës, dallojmë ç'është fjalë ç'nuk është e tillë.

Njësi gjuhësore më e ulëta se fjala në vargun e njësive që treguam më lart, janë fonema dhe morfema. Fonema (që shënohet në alfabet me shkronjë: a, b, c..) është njësi fonetike, ajo *s'ka fare kuptim leksikor, as është mbartëse e ndonjë nuance kuptimore*. Morfema (për-pun-oj), që gjendet më pranë fjalës, është njësi morfologjike *nuk ka kuptim leksikor te pavarur, kurse ne rrafshin leksikologjik, është mbartëse e kuptimit gramatikor*, por këtë vlerë e shpërfaq vetëm brenda fjalës⁴. Duke qenë se është njësia më e vogël e fjalës, nuk mund të zërthehet në njësi më të vogla të kuptimshme⁵.

Njësi gjuhësore më të larta se fjala janë togëfjalëshi dhe fjalia, të cilat dallohen qartë nga fjala. Si togëfjalëshi, ashtu edhe fjalia, ndryshe nga fjala, janë njësi sintaksore dhe kanë strukturë të hapur. Togëfjalëshi (*dritarja e dhomës, rrugë e gjerë, nge lart...*) përbëhet prej fjalësh dhe shpreh lidhje konceptesh. Fjalia (*hapi dritaren e dhomës, ndërtnuan rrugë të gjera, e ngriti lartë emrin e vendlindjes..*) përbëhet prej togëfjalësh dhe është *njësi kumtuese*, shpreh mendim, dëshirë, urdhër, pyetje etj. Dihet që kemi fjali edhe me një fjalë: - *Zjarr!*; - *Shpejt!*; - *Mëngjes*; - *Ndal!*;

⁴ Thomai, Jani, "Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2006, fq.34

⁵ Jashari, Citaku "Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 Morfologjia", 2003, fq.14

Po bashkëpunoj, gojëmbël, këmbëngul, krahëhapur, kryeqytet, ndonjëherë, zëvendskryeministër, zemërgur... si duhet të shpjegohen?.

Këto njësi të përbëra e të përngjitura janë fjalë e jo togëfjalësha, sepse shprehin një kuptim tërësor, shënojnë një koncept të vetëm dhe kanë strukturë të mbyllur. Kështu, psh., *syzi* nuk është e ndërtuar për të shprehur marrëdhënien ndërmjet *sy* dhe mbiemrit sipas ngjyrës *i zi* (sikur togëfjalëshi *sy i zi*), porse si mbiemër, për të shënuar një tipar të caktuar të njeriut (djalë *syzi*). Kjo do të thotë që raportet e brendshme semantike e sintaksore të togfjalëshit (*sy i zi*) të fjala e përbërë (*syzi*) ose janë zbehur shumë ose janë zhdukur fare. Po ashtu edhe të *mendjemadh* duket bashkimi i temës së emrit femëror (*mendje-*) me temën e mbiemrit mashkullor (*-madh*) dhe për shkak të strukturës së mbyllur mbiemri i përbër femëror është fjalë e jo togëfjalësh.

3.2. Forma dhe kuptimi i fjalës

Fjala është njësia themelore e fjalisë. Të gjitha fjalët e një gjuhe përbëhen nga forma dhe kuptimi. Forma është tërësia e tingujve në të folur ose e shkronjave në të shkruar që ndërton fjalën. Forma e fjalës lidhet me kuptimin e saj.

Fjala përbëhet nga tema dhe mbaresa. Tema është ajo pjesë e fjalës që mbetet pasi heqim mbaresën. Një teme mund t'i shtohen parashtesa ose prapashtesa. Në këtë rast ajo quhet temë fjalëformuese. Mbaresa jep veçoritë gramatikore të fjalës.

Fjalët në gjuhën shqipe janë të parme dhe jo të parme. Fjala quhet e parme kur tema është e njëjtë me rrënjën, p.sh., *flutur-a*, *këng-a* etj. Fjala quhet jo e parme kur është formuar me parashtesë ose prapashtesë, ose të dyja bashkë, si dhe me mënyra të tjera. Fjalët jo të parme janë: *të prejardhura*(*flutur-o-j*), *të përbëra* (*bukë+pjekës*) dhe *të përngjitura* (*megjithatë*).

Fjalët e prejardhura janë të formuara me anë të bashkimit të ndajshesave fjalëformuese me tema fjalëformuese. Sipas llojit të ndajshesës fjalëformuese dhe sipas mënyrës së bashkimit të saj me temën, dallohen këto lloje të prejardhjes: 1) *prejardhja parashtesore* (i paaftë= i-pa -aftë)

2) *prejardhja praprashtesore* (trimëri= trim- më-ri) 3) *prejardhja parashteso-prapashtesore* (përfundoj= për- fund- oj)⁶.

Fjalët e përbëra janë të formuara nga dy ose më shumë tema. Fjalët e përbëra mund të jenë: a) *emra* (frymëmarrje = frymë + marrje); b) *mbiemra* (flokëverdhe = flokë + verdhë); c) *folje* (buzëqesh = buzë + qesh); d) *ndajfolje* (duarkryq = duar + kryq);

Fjalët e përngjitura janë të formuara nga një grup fjalësh apo nga togëfjalësh si: *farefis* (farë e fis), *gjëegjëzë* (gjë e gjëzë), *trembëdhjetë* (tre- mbë-dhjetë); etj⁷.

3.3. Grupet (paradigmat) e fjalëve

Duke studiuar sistemin e gjuhës kuptojmë se dallojmë grupe (klasa) fjalësh me tipare të përbashkta siç janë: a) Homonimet, b) Antonimet c) Sinonimet⁸.

Antonimet janë fjalë, të cilat kanë kuptim të kundërt me njëra-tjetrën: *mëngjes – mbrëmje*;

Sinonimet janë fjalë, të cilat shkruhen ndryshe, por që kanë kuptim të njëjtë me njëra-tjetrën: i *brengosur – i merakosur*;

Homonimet janë fjalë që shkruhen ose shqiptohen njësoj, por që kanë kuptim të ndryshëm: *akrep* (kafshë e vogël helmuese, e zezë) – *akrep* (shigjetëzat që rrotullohen në orë)

⁶ Jashari, Citaku “ Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 Morfologjia”, 2003, fq.20-22

⁷ Jashari, Citaku “ Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 Morfologjia”, 2003, fq.20

⁸ Thomai, Jani, “Leksikologjia e gjuhes shqipe”, 2006, fq.138

3.1. Leksiku i të folmes në rajon të Lipovecit.

Sistemi më i vogël i dialektit është e folmja⁹. Fjalët dialektore e krahinore janë fjalë që përdoren vetëm në një të folme të caktuar, që nuk përdoret në të folmet e tjera. Ndryshe nga profesionalizmat, leksiku krahinor ka kufizim truallsor, ai është leksik i një të folme të veçantë që mbulon një të folme të kufizuar.

Meqë, rajoni i Lipovecit i përketë zonës së Hasit kjo nënkuptonë që në këtë rajon kemi të bëjmë me leksikë të fjalëve që i përkasin të folmes së dialektit verior. E folmja e brezit të ri pak a shumë është bashkëkohore, por nuk është në nivel të gjuhës standarde. Ajo kryesishtë kultivon edhe ruajtje të së folmes së vjetër (të dialektit gegë), që edhe sot përdoren shumë fjalë si : *pështoj (shpëtoj), tamël (qumësht), kojshi(fqinj), kollomoq(misër), hajn (hajdut), kepë(qepë), korit (turpëroj), sosa (mbarova) gastare (gotë prej-qelqi), vârr (plagë), korub (zgjua bletësh), gac (thëngjill), kundër(këpucë), patëlxhan (domate), nirth (me pas të ftohtë), ani (e ngjashme me pra por jo saktësisht), nja (një), bâj (bëj), êmën (emër), mret (mbret), gjëndje (gjendje), lloq (baltë), tutë (frikë), thî (derr), knus (gjel), muj (mundem), nashta (ndoshta), katun (fshat), grûn (grurë), gru (grua), nrroj (ndërroj), mzat (mëzat), ftyr (fytyr), dryn (çelës), rrej (gënjej), zgedh (zgjedhë), zgjidh (zgjidh), delme (dele), kinxhi (qenxhi), ftu (ftua), langi (lengu)¹⁰ etj.*

Në këtë të folme, është e përhapur shumë kategoria e të folurit me mbaresat *ja, va, i*:

Shembull me mbaresë (va) : lava, shava, ndava, punova, tregova, blova, theva,..

Shembull me mbaresën (i): kali, miki, krahi, ahi, plehi, zogi, xhaki, langi, bregi¹¹,..

Shembull me mbaresë (ja): nusja, lulja, çershija, kajsia,..

Sa i përketë mbaresës (ja), karakteristikë në këtë rajon po edhe edhe në rajone tjera të gjakovës është se përveç emrave femrorë këtë mbaresë e marrin edhe emrat mashkullor në rasën kallxore, trajten e shquar:

⁹ Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., "Dialektologjia", 2000, fq.31

¹⁰ Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., "Dialektologjia", 2000, fq.52, 214.

¹¹ Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., "Dialektologjia", 2000, fq.14.

Shembull : Atdheja (Atdheu), Kadrija (Kadriu), Alija (Aliu),..

Leksikun e e fjalëve të këtij rajoni e bën të dallushëm nga leksiku i gjuhës standard edhe *trajta* fonetike dhe ajo e përemrave.

Trajta fonetike hundore (*â, ê, î, ô, ý, û*) që nuk ndryshon për nga fjalët shembull:

âsht (është), ânderr(ëndërr), bâjt (bart), nâna (nëna), drû-ni (dru-ri), dhân (dhënë), grû (grua), gjâ (gjë), jêm (imi), jême (imja), hû-ni (hur-ri), mên (mendje), mullî (mulli), mâ (më), "mrêna"(mbrenda), nâten (natën), kâm- a (këmbë-a), têm (tim), tême (time), tâne (tënde), zûra (zura), zân (zënë), vên (vend), vorr-i (varr-i),¹²etj.

Përdorimi i këtyre zanoreve hundore zëvendësojnë thujtë plotësisht tingullin e theksuar "ë" që në gegërishte figuron si shkronjë për zgjatjen e zanores paraprijëse.

Dallimet midis kësaj të folme dhe shqipes letrare shihen edhe te përemrat.

Përemrat pronorë vetvetorë: *i vet* (djali i vet), *e vet* (shpija e vet), *të vet* (në pleqni të vet).¹³

Për rasën emërore kanë variantet *êm, jêm* për mashkulloren (*kali êm, kali jêm*) dhe *ême, jême* për femëroren (*lopa ême, lopa jême*), kurse për rasat e zhdrejta kanë *têm* dhe *tême*.

Karakteristikë tjetër e këtij leksiku është edhe prania e foljeve jonormative në të kryerën e thjeshtë: *pruna (prura), hangra (hëngra), keshë (qeshë), ndejta (ndenja), deshta (desha), deka (vdiqa), ndjeka (ndoqa)*, etj¹⁴.

¹² Thomai, Jani, "Leksikologjia e gjuhes shqipe", 2006.

¹³ Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., "Dialektologjia", 2000, fq.219

¹⁴ Shkurtaç, Gjovalin, "Kultuë e Gjuhës", 1988, fq.162

3.2. Fjalëformimi

Veçoritë dialektore, të cilat kanë bërë të mundur përvijimin e dialekteve, nëndialekteve apo dhe të folmeve të veçanta, lidhen dhe me mënyrat e formimit të fjalëve.

Prejardhja është një nga mënyrat kryesore të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. Me anë të ndajshesave, si mjete kryesore fjalëformuese, dhe nyjës, si mjet gramatikor, krijohet një shtresë shumë e gjerë fjalësh me kuptime të reja.

3.2.1 Prejardhja parashtesore

Parashtesat janë morfema fjalëformuese, që qëndrojnë para rrënjës ose para një parashtese tjetër, si *për-* hap, *zh-*vendos, *ri-*përpunoj.

Në formimet parashtesore, përgjithësisht, nuk ndryshon kategoria leksiko-gramatikore e fjalëve dhe janë më të pakta ¹⁵ndërsa prejardhja prapashtesore paraqitet më e larmishme.

Në përgjithësi prejardhja parashtesore e fjalëve në këtë rajon është pothuajse e njëjtë me atë të gjuhës standarde, megjithatë ka dhe pak dallime, psh. Karakteristike është pjesëza *ç-* e cila gjendet rëndomt në të folmen e Lipovecit si parashtesë. U ngjitet ndajfoljeve të vendit si: *çatje(atje)*, *çitu(këtu)*, *çanej(andej)*, *çiknej(këndej)*, dhe ndajfoljeve të mënyrës: *çashtu(ashtu)*, *çishtu(kështu)*. Përemrave dëftor u është paravënë kjo parashtesë si: *çaj(ai)*, *çajo(ajo)*, *çata(ata)*, *çato(ato)*, *çiky(ky)*, *çikjo(kjo)*, *çita(këta)*, *çito(këto)*.

¹⁵ Jashari, Citaku “Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 Morfologjia”, 2003, fq.20

3.2.2. Prejardhja prapashtesore

Prapashtesat janë morfema fjalëformuese, që qëndrojnë pas rrënjës ose pas një prapashtese tjetër, si hekur –*t*, rrjedh-*im*, drejt-*or*, bes-*nik*.¹⁶

Në të folmen e Lipovecit ka një larmi prapashtesash shqipe dhe të huazuara, të cilat formojnë grupe fjalësh dhe fjalëformash karakteristike për të folmen e krahinës. Disa formante të truallit vendës janë përzier me ato të huazuara (kryesisht sllave e turke).

Në formimet prapashtesore të të folmes së Lipovecit dallohen këto variante kryesore prapashtesore:

-*ush*- prapashtesë që përdoret për emra që shprehin nuance të ndryshme emocionuese psh : babush, nanush, tezush, lepurush,..

-*shna*- te folja, marshna, lajshna,

-*ke*- vrajke, marrke,¹⁷

Prapashtesat -*aç* , *icë* janë të burimit sllav¹⁸. Prapashtesa *aç* : ndaç (nëse don), Me prapashtesën -*icë* formohen emra femërorë nga tema emërore: baçicë, magaricë (shamje për gjinin femërore), budallicë, etj.

Me prapashtesa –*avec* si rrjedhim i burimit të saj nga bullgarishtja, dhe që ka hyrë në këtë rajon nëpërmjet fjalësh sllave, si: kastravec

Nga turqishtja bashkë me fjalët kanë hyrë edhe disa prapashtesa si: -*xhi*, *çi*, *llarë*, *lerë*, *llëk*, të cilat më vonë janë shtuar edhe temave të tjera, si¹⁹: *furraxhi*, *sharraxhi*, *sahatçi*, *budallëk*,¹⁹.

¹⁶ Jashari, Citaku " Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 Morfologjia", 2003, fq.16

¹⁷ Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., "Dialektologjia", 2000, fq.162

¹⁸ A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat në gjuhën shqipe, "Studime gjuhësore III", Rilindja, Prishtinë,1977, f. 196.

¹⁹ Shkurtaç, Gjovalin, "Kultuë e Gjuhës",1988.

Prapashtesa turke –*llëk* përdoret për të formuar fjalë me kuptim konkret, si: kallaballëk, apo dhe me kuptim abstrakt, si: budallallëk, gomarllëk, nikoqirllëk, qyqllëk etj. Kjo prapashtesë ka hyrë bashkë me fjalët turke përkatëse dhe është bërë prodhimtare edhe me tema nga shqipja.

3.3. Huazimet

Gjithashtu leksikun e fjalëve të këtij rajoni e përbëjnë edhe shprehjet që janë formuar brenda shqipes ose *janë huazuar nga gjuhë të tjera*. Huazimi i fjalëve nga gjuhë të tjera është bërë nganjherë edhe kur për të njëjtat koncepte kemi pasur fjalë të tjera në përdorim. Siç dihet, fjala është njësi gjuhësore që huazohet më lehtë dhe më shpejt. Kështu, huazimet ndërmjet gjuhësh të ndryshme janë kryesisht huazime leksikore. “Ato janë shenja, gjurmë që kanë lënë afërsia dhe takimet (kontaktet) e shkëmbimet e ndryshme me popujt që i kanë folur dhe i flasin ato gjuhë²⁰”. Në përgjithësi huazimet në rajon të Lipovecit janë të njëjta po thuajse me shumicën e huazimeve të rajoneve të tjera në vendin tonë. Huazimet e fjalëve në këtë rajonë rrjedhin nga burime të ndryshme gjuhësore të vendeve të ndryshme, mirëpo kryesisht kemi burime të fjalëve nga serbishtja, turqishtja, arabishtja.. etj.

²⁰ Shkurtaj, Gjovalin, “Kultuë e Gjuhës”,1988, fq.169

3.3.1. Fjalë të burimit sllav

Fjalë nga sllavishtja (nga serbishtja dhe bullgarishtja) kanë hyrë në shqipe gjatë mesjetës. Fjalë të burimit sllav kemi në bujqësi, në blegtori, në xejtari, në organizimin shoqrorë etj.

Shprehjet që ende dhe shpesh përdoren në rajon të Lipovecit edhe nga të rinjtë janë këto që i kemi paraqitur më poshtë:

- *Çekiç-mjet i vogël me kokë metalike me majë, që ngrohet shumë për të ngjitur me kallaj.*
- *Çudit-kall. E lë pa mend dikë, e lë me gojë hapur me diçka të jashtëzakonshme ose shumë të mirë, e mahnit.*
- *Fllad - m. Erë e lehtë, e freskët dhe e këndshme,. Fllad pranveror. Flladi i mëngjesit i mbrëmjes. përd. ndajf. Freskët. Është (bën) fllad.*
- *Mërzit - kall. Piklloi dikë për diçka.²¹*
- *Pushkë- f. armë zjarri me tytë të gjatë që mbahet në krah dhe që mund të qëllojë duke i nxjerrë fishkët një nga një ose në mënyrë gjysmautomatike.*
- *Prashit - kall. Rrëmoj jo thellë, tokën e mbjellë.*
- *Grabit - kall. Marr me forcë një gjë që i përket dikujt tjetër dhe e bëj timen²².*
- *Baticë, em. serb. zonjë shtëpie, gruaja që e shikon mbarëvajtjen e shtëpisë.*
- *Troha/ trosha, em. serb. thërrmija.*
- *Teslicë, em. serb. sqepar,*
- *Kërrutë, em. serb. bastun*
- *Mraz, ndajf. serb. i ftohtë i madh.*
- *Jakne, em. serb. xhaketë.*
- *Shtagë, em. serb. shkop*
- *Kauç, em. serb. divan*
- *Jiti, em. serb. hekur për hekurosje*
- *Kaci, em. serb. lopatë me bisht të gjatë.*
- *Zhabë- em. serb. bretkosë*

²¹ Shkurtaç, Gjovalin, "Kultuë e Gjuhës", 1988, fq.174

²² Thomai, Jani, "Leksikologjia e gjuhes shqipe", 2006, fq.259.

- *Penzija- f, -pension.*
- *Soba- dhomë.*
- *Shumar- rojtar pylli*
- *Sialica- llambë (elektrike).*
- *Struja- rrymë.*

Ka edhe më shumë fjalë të huazuara sepse ndikimi sllavë ka qenë i fortë edhe në këtë rajon.

3.1.2. Fjalë të burimit turk

Një tipar që e shquan të folmen e rajonit të Lipovecit është edhe prania e një shtrese fjalësh të ardhura nga turqishtja, “të cilat disa studiues i quajnë thjesht turqizma e disa orientalizma, meqë një pjesë e mirë e tyre janë me burim nga arabishtja e nga persishtja dhe turqishtja²³”. Si në gjithë gjuhën shqipe standard e jostandard edhe në të folmen e Lipovecit ndeshim mjaft turqizma të cilat janë më të dukshme në të folmen tek mosha e tretë.

Mirëpo, nuk mohohet fakti që edhe gjithë moshat e tjera kanë pothuajse të njëjtin leksemë e të folurit të përditshëm të tyre, si:

- *Avitem, folje, afrohem.*
- *Baballëk, em. turq. vjehrri i dhëndrit ose Babai i gruas.*
- *Bacë/baca, em, vëllai i madh.*
- *Badihava, ndajf. turq. kot, kot së koti.*
- *Bahce, em. turq. kopsht.*
- *Baxhanak, em. turq. kunati, gratë motra.*

²³ Emil Lafe, Vendi i orientalizmave ndër huazimet e shqipes, Studime filologjike, nr. 1-4, 1993, f. 35. 94

- *Beter, mb. turq. njeri i shëmtuar.*
- *Bujrum, pasth. turq. Mirë se erdhe.*
- *Dakik, em. turq. minutë ose çast.*
- *Dert, em. turq. shqetësim- mundim.*
- *Dynja, em. turq. botë.*
- *Evlat, em. turq. fëmijë.*
- *Fikall- ndajf. turq. i vetmuar (është fikall).*
- *Harxh, em. turq. bën pazarin e shtëpisë.*
- *Helbete, ndajf. turq. ndoshta, (helbete del naj sen).*
- *Inxhe, em. turq. gruaja e xhaxhait.*
- *Itibar, em. turq. nderim, respekt.*
- *Izën, ndajf. turq. lejë për të shkuar (a po ma jepni izën).*
- *Javash, ndajf. turq. ngadalë. - japi, em. turq. shtëpi.*
- *Kabile, em.mb. turq. familja e gjerë.*
- *Kerr, em. turq. qerre, makinë.*
- *Kimet, em. turq. rëndësi, vlerë.*
- *Kismet, ndajf. turq. fat, përdoret për të uruar në të ardhmen (kësmet po martohem).*
- *Mesele, em. turq. tregim, ndodhi.*
- *Misit, mb. turq. përfson që shkon për shkuesi.*
- *Mixhë, em. turq. xhaxhai*
- *Nalet, em. turq. djall. dreq.*
- *Tavan, em. turq. pjesa e sipërme që mbulon një dhomë.*
- *Tomel, em. qumësht, thuhet se rrjedh nga fjala shqipe d.m.th. i ëmbël-amël-omel.*
- *Teshem, f. u takova me dikë*
- *Tezak, em. turq. Djali i tezes.*
- *Xhade, em. turq. rrugë.*
- *Xham, em. turq. qelq.*
- *Zullum, ndajf. turq. dëm, i bën zullum- i bën dëm*

- *Hallvë, em. turq. ëmbëlsirë që bëhet me miell të skuqur, me vaj ose me gjalpë dhe me sheqer*²⁴.

Përveç sa theksuam më sipër, në të folurit e Lipovecit përdoren krahas fjalëve turke, serbe, edhe fjalë arabe, kryesisht ato me karakter fetar-islam.

P.Sh

- *Allahile, pasth. arab. pashë Zotin!*,
- *Kijameti-, fundi i botës,*
- *Çafiir- jobesimtar, i pafe,*
- *Nijeti - qëllimi,*
- *Insha'Allah (në dashtë zoti),*
- *Kurban: (arab.)- sakrificë, prerja e një kafshe në emër të Zotit qoftë ai dash, viç apo deve.*
- *Haku- (e drejta),*
- *Adet- shprehi, traditë, zakon, dok.*
- *Bereqet: (arab.) – Dhunti, begati e Allahut nga pikëpamja materiale dhe shpirtërore. bekim, përparim, fat etj*²⁵

²⁴ *Po aty,*

²⁵ Mikel Ndreca, "Fjalor Fjalësh e Shprehjesh të Huaja" , Prishtinë, 2000, fq. 86

3.3. **Përfundim**

Në këtë punim synuam që të vëmë në dukje përbërjen e leksikut të rajonit të Lipovecit.

Gjatë këtij punimi, shifet se kjo e folme dallon nga të folmet e tjera në njësi të imta dialektore, me disa tipare karakteristike. Megjithatë, nuk ka dallim të madh me të folmet e tjera në rajon të Kosovës, sepse sistemi i formimit të fjalëve në këtë rajon, është si kudo në Kosovë dhe në përgjithësi në dialektin gegë . Në përgjithësi kemi leksikë që paraqitet me larmi të variacioneve, që shfaqen me vlera të burimeve leksikore të ndryshme.

Edhe pse në këtë punim është paraqitur leksik i përbërë nga ruajtja (konservimi) i fjalëve të dialektit gegë dhe nga disa fjalëve të huaja, megjithatë në këtë rajon po ndodhë përtëritja (rinovimi) e të folmes nën drejtimin standardizues. Dallimet leksikore të brezi i vjetër me format e mirëfillta dialektore vendase, tanimë të brezi i ri janë unifikuar në kahun e një shqipeje më të kuptueshme, duke u forcuar gjithnjë e më tepër pas çlirimit të vendit. Është kapërcyer mbyllja dialektore, duke pasur përzierje të folësve si grupesociale, profesionale, arsimore, etj.

3.4. BIBLIOGRAFIA

1. De Saussure, Ferdinand, “Kurs i gjuhësisë së përgjithshme” Dituria, Tiranë, 2002.
2. Gjevori, Mehmet, “Frazeologji shqipe” Rilindja, Prishtinë, 1968.
3. Gjinari, Jorgji dhe Shkurtaç, Gjovalin, “Dialektologjia”, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003.
4. Shkurtaç, Gjovalin, “Kulturë e Gjuhës”, redaktuar nga Gjylso Binaj.
5. Grup autorësh (Instituti Albanologjik i Prishtinës), “Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore” Prishtinë, 1982.
6. Grup autorësh (Universiteti Shtetëror i Tiranës), “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve të gjuhës shqipe” Mihail Duri, Tiranë, 1972.
7. Kajtazi, Halil “Fjalë të urta nga Drenica” ULPI, Prishtinë, 2015.
8. Lloshi, Xhevat “Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe” Rilindja, Prishtinë, 1988.
9. Lloshi, Xhevat “Stilistika dhe pragmatika” Toena, Tiranë, 1999.
10. Martine, Andrea “Elemente të gjuhësisë së përgjithshme”, Rilindja, Prishtinë, 1974.
11. Memushaj, Rami, “Hyrje në gjuhësi” Dituria, Tiranë, 2004.
12. Memushaj, Rami, “Shqipja standardizuese”, Toena, Tiranë, 2004.
13. Jashari, Citaku, “Gramatika e Gjuhës Shqipe 1 – Morfologjia”, Artini, Prishtinë 2003
14. Thomai, Jani “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, Toena, Tiranë, 2006.